



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Shpallje për lëvizje paralele
Ngritje në detyrë
Në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese

Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Qarkut Korçë shpall procedurat e lëvizjes paralele, dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

1 (Një) Përgjegjës i Sektorit Juridik, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve - kategoria: III

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për dy procedurat; lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Lëvizje paralele

07.07.2025

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

Ngritje në detyrë

12.07.2025

Përshkrimi i punës për pozicionin si më sipër është:

Organizon, koordinon dhe mbikëqyr punën për të gjitha çështjet që lidhen me përgjegjësitë e pozicionit dhe burimet njerëzore, ku përfshihen: rekrutimi, përzgjedhja, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, pezullimi, transferimi, procedurat disiplinore, përfundimi i marrëdhënieve të punës dhe lirimi nga shërbimi civil sipas ligjit, trajnimi dhe aftësimi profesional, hartimi i planit vjetor për pranimin në shërbimin civil, përgatitja dhe administrimi i dosjeve të personelit, raportimi pranë KMSHC, informimi i titullarit për konfliktet e interesit të lidhura me emërimet dhe për çdo konflikt interesi që konstatohet në lidhje me administratën, monitorimi i normave të etikës në administratë, kontrolli mbi zbatimin e disiplinës në punë dhe respektimin e rregullores së administratës, mirëmbajtja e regjistrit themeltar të personelit dhe Regjistrin Qendror të Personelit (HRMIS), përgatitja e listë - prezencës mujore të punonjësve dhe hartimi i planit për pushimet vjetore, si dhe çdo detyrë tjetër e përcaktuar me ligj ose me rregulloren e administratës të Këshillit të Qarkut, ose e përcaktuar dhe deleguar nga titullari i institucionit.

1

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë III;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" në "Shkenca Ekonomike". Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.
- c- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- d- Të kenë aftësi të mira menaxheriale;
- e- Të zotërojnë njohuri për procedurat administrative;
- f- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve bazë të kompjuterit.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**Kandidatët që aplikojnë bashkë me kërkesën duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:**

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
(Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës)
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- j- Një kërkesë ku ju specifikoni pozicionin ku dëshironi të konkuroni.

*Dokumentat duhet të dërgohen me postë ose të dorëzohen në institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, në adresë:
Lagjia 7, Rruga “28 Nëntori”, Korçë 7001, Shqipëri, brenda datës: **07.07.2025***

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **09.07.2025**, Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Këshilli i Qarkut Korçë për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4**FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i punës së republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i republikës së shqipërisë”
- Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”. i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 109, datë 26.2.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 116, datë 5.3.2014 (Ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014) “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “për nëpunësin civil”
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil”

1.5**MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al” <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Korçë, do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Korçë, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Këshillit të Qarkut Korçë, duke filluar nga data 12.07.2025

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor" në "Shkenca Ekonomike", edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në Administratë Publike.
- c- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi;
- d- Të kenë aftësi të mira menaxheriale;
- e- Të zotërojnë njohuri për procedurat administrative;
- f- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve bazë të kompjuterit.

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
(Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës)
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- j- Një kërkesë ku ju specifikoni pozicionin që dëshironi të konkuroni.

*Dokumentat për procedurën e ngritjes në detyrë duhet të dërgohen me postë ose të dorëzohen në institucionin e Këshillit Qarkut Korçë, në adresë: Lagjia 7, Rruga "28 Nëntori", Korçë 7001, Shqipëri, brenda datës: **12.07.2025***

2.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data **15.07.2025**, Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Këshilli i Qarkut Korçë, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohritë mbi ligjin nr. 139/2015 Datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i punës së republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike";
- Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i republikës së shqipërisë"
- Njohuritë mbi ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 125, datë 17.2.2016 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë";
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 124, datë 17.2.2016 "Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil". i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 243, datë 18.3.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 242, datë 18.3.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 116, datë 5.3.2014 (Ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014) "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "për nëpunësin civil"
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 115, datë 5.3.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" i ndryshuar;

- Njohuritë mbi VKM-në nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar;
- Njohuritë mbi VKM-në nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë dhe kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Qarkut Korçë do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Këshilli i Qarkut Korçë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.